



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 530 Akti

Nr. 579 Vendimi  
Tiranë, më 28.10.2022

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Lulzim Hamitaj</b>	<b>Relator</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Theo Jacobs, në datën 26.10.2022, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Edvan Veçani**, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Edvan Veçani, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 26.10.2022, kërkoi konfirmimin në detyrë,

### VËREN:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Edvan Veçani, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimit Edvan Veçani i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur, në datën 15.6.2020, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo), pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
  - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
5. Gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike të datës 22.7.2020, konfirmoi mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues.
6. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Edvan Veçani, me vendimin nr. 2, datë 18.10.2022, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
7. Komisioni, në datën 19.10.2022, e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara

prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 24.10.2022.

**8.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 20.10.2022, u paraqit për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ dhe për tërheqjen e dokumentacionit fizik dhe në formë elektronike, të cilat iu vunë në dispozicion së bashku me rezultatet e hetimit kryesisht.

**9.** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike në datën 24.10.2022, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 24.10.2022, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 26.10.2022, duke njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**10.** Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 26.10.2022, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

**11.** Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Edvan Veçani parashtrroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 26.10.2022 u mbyll, për të rifilluar në datën 28.10.2022 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

## **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet dhe dokumentacionin e paraqitur në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja**

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë në pronësi të prindërve;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

### **1. Apartament në përdorim, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë**

1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se banon<sup>1</sup> në apartamentin në pronësi të prindërve<sup>2</sup> të tij së bashku me bashkëshorten<sup>3</sup> dhe vajzën, pasuri që ndodhet në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, e blerë nga prindërit e tij nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*\*, datë 4.4.2013, kundrejt çmimit 145.000 euro.
2. Në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar marrjen e një kredie në shumën 80.000 euro në bankën “S. G. Albania”, së bashku me nënën e tij V. V., si dhe në deklaratën *Vetting* ka bërë me dije se kredia në fjalë shlyhet nga prindërit e tij.
3. ASHK Tirana Jug<sup>4</sup>, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 7.2.2022, ka konfirmuar regjistrimin e apartamentit në pronësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit, E. dhe V. V., pasuri kjo e përfutur me anë të kontratës së shitjes me kusht kreditimi nr. \*\*\*\*, datë 4.4.2013, me palë shitëse znj. F. L., në mënyrë të tillë që kalimi i pronësisë tek ata të bëhet me realizimin e kushtit të likuidimit total të çmimit të shitjes prej 145.000 euro, i parashikuar si vijon:
  - a) *kësti i parë* në shumën 65.000 euro, likuiduar në ditën e nënshkrimit të kontratës nëpërmjet transfertës bankare në BKT të shumës 49.252 euro dhe në “Credins Bank” të shumës 15.750 euro;
  - b) *kësti i dytë* në shumën 80.000 euro do të likuidohet me disbursimin e kredisë nga banka.

<sup>1</sup>Në përgjigjet e tij të pyetësorit nr. 1, subjekti është shprehur se ka filluar të banojë në këtë apartament duke filluar nga muaji prill 2013, çka përputhet dhe me deklarin duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2013 e në vijim.

<sup>2</sup>Nga shqyrtimi i DIPP-së, pas largimit nga funksioni i babait të subjektit në vitin 2013, është deklaruar apartamenti në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.

<sup>3</sup>Subjekti ka bërë me dije se bashkëjetesa me bashkëshorten ka filluar në muajin shkurt 2016.

<sup>4</sup>ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 6.2.2018 dhe ASHK-ja me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 26.1.2022, kanë bërë me dije se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit Edvan Veçani. Ndërsa lidhur me personat e lidhur, E. dhe V. V., ASHK Tirana Jug, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 7.2.2022, ka bërë me dije se ata kanë/kanë pasur përkatësisht të regjistruara tri pasuritë me nr. \*\*\*\*, nr. \*\*\*\* dhe pasuria nr. \*\*\*\*, nga të cilat pasuria e parë është tjetërsuar në datën 20.2.2013, pasuria e dytë është blerë pas periudhës së rivlerësimit në datën 26.1.2018 dhe e treta është pasuria në analizë.

4. Nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare ka rezultuar se në datën 19.4.2013, në llogarinë dyemërore të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij pranë “OTP Bank” është disbursuar një kredi në shumën 80.000 euro, nga e cila vlera 79.150 euro është transferuar në po të njëjtën ditë në llogari të palës shitëse, znj. F. L.<sup>5</sup>.
5. Në vijim të hetimit administrativ, me qëllim qartësimin e pozitës juridike të subjektit të rivlerësimit për sa i takon posedimit dhe përdorimit nga ana e tij, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije arsyen përse apartamenti është regjistruar në emër të prindërve të tij, por që posedohet/përdoret prej tij, duke pasur në konsideratë gjithashtu faktin se kredia bankare prej 80.000 euro është marrë edhe nga ana e tij dhe është shlyer së paku deri në vitin 2016. Po ashtu, Komisioni i ka kërkuar subjektit të jepte shpjegimet e tij mbi arsyen përse kredia është marrë edhe në emrin e tij, ndërkohë që apartamenti është regjistruar vetëm në emër të prindërve.
6. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se arsyeja e marrjes së kredisë ka qenë për shkak të moshës së madhe të prindërve të tij dhe, për këtë arsye, banka u ka kërkuar që kredia të merrej nga subjekti dhe nga nëna e tij, po ashtu ka shpjeguar se apartamenti mund të ishte në pronësinë e tij vetëm nëse prindërit do të kishin vendosur t’ia dhuronin këtë pasuri atij dhe se ky apartament është përdorur në mënyrë të vazhdueshme edhe nga vëllai i tij<sup>6</sup>.
7. Komisioni, në funksion të kryerjes së hetimit të plotë dhe të gjithanshëm, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2 të shprehej edhe mbi ekzistencën e mundshme të ndonjë marrëdhënieje të tij shoqërore, familjare apo të çfarëdolloji, përfshirë edhe konfliktin e interesit me shtetasen L. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka shpjeguar se nuk ekziston asnjë konflikt interesi me të dhe, po ashtu, ka paraqitur shkresën kthim përgjigje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>7</sup> dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër<sup>8</sup>, të cilat kanë konfirmuar se subjekti i rivlerësimit Edvan Veçani nuk ka trajtuar asnjë çështje me palë shtetasen e sipërcituar.
8. Në vijim të administrimit të dokumentacionit ka rezultuar se FSHU-ja, me shkresën nr. \*\*\*, datë 13.8.2020, është bërë me dije se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk ka ndonjë kontratë të regjistruar po ashtu, UKT-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.8.2020, ka bërë me dije se nuk ka rezultuar asnjë e dhënë në emër të këtij subjekti për ekzistencën e ndonjë kontrate shërbimi.
9. Ndonëse kualifikimi si bashkëkredimarrës nuk përfshihet në marrëdhëniet e interesit të listuara në përmbajtje të ligjit nr. 84/2016, por nisur nga përdorimi/posedimi i këtij apartamenti në vijimësi nga ana e subjektit të rivlerësimit si dhe, në kuadër të një hetimi gjithëpërfshirës, Komisioni, ka analizuar burimet financiare të krijimit të pasurisë në fjalë, nga ana e prindërve të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë mundësuar blerjen e pasurisë në fjalë.

## **1.1. Analizimi i burimeve të krijimit të kësaj pasurie**

### **1.1.1. Analizimi i burimeve për pagesën e kësaj pasurie të parë prej 65.000 euro**

<sup>5</sup>Në datën 11.6.2013, pala shitëse, me anë të një deklaratë noteriale nr. \*\*\* ka deklaruar se është likuiduar totalisht nga pala blerëse E.V., deklaratë e cila konfirmohet edhe nga Ministria e Drejtësisë, RNSH-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.8.2020.

<sup>6</sup>Z. A. V., vëllai i subjektit të rivlerësimit.

<sup>7</sup>Referojuni kthim përgjigjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër me nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, si dhe shkresave nr. \*\*\*, prot., datë 14.12.2021, nr. \*\*\*, datë 15.12.2021, nr. \*\*\*, datë 1.2.2022.

<sup>8</sup>Referojuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, si dhe shkresës nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 17.6.2022.

10. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se pagesa e këstit të parë për blerjen e apartamentit në shumën 65.000 euro është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës së shitjes me kusht më 4.4.2013, sipas mandatpagesave përkatësisht:
- transfertë bankare e shumës 15.750 euro nga llogaria në “Credins Bank” e babait të subjektit, z. E. V., në favor të palës shitëse F. L., me përshkrimin “kalim për kontratë shitje apartamenti”;
  - transfertë bankare e shumës 49.252 euro nga llogaria dyemërore e prindërve të subjektit, E. dhe V. V., në favor të palës shitëse F. L., me përshkrimin “pagesë për blerje apartamenti”.
11. Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të shumave të sipërcituara të përdorura për shlyerjen e këstit të parë të çmimit të apartamentit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se burimi i krijimit të shumave rrjedh nga shitja e një apartamenti në datën 20.2.2013, në pronësi të prindërve të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”<sup>9</sup>, Tiranë, me nr. pasurie \*\*\*, në z. k. \*\*\*, me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>. Ky apartament është shitur nga prindërit e subjektit kundrejt çmimit 8.750.000 lekë shtetasve N. dhe S. H. Komisionit i ka rezultuar se nga analizimi i lëvizjeve bankare në llogarinë e prindërve të tij ka rezultuar se në datën 19.3.2013, në llogarinë e tyre në BKT, janë transferuar përkatësisht shumat 3.430.310 lekë nga z. S. H. dhe 3.465.000 lekë nga znj. N. H.<sup>10</sup>, me përshkrim të dyja për likuidimin e këstit të fundit të çmimit të apartamentit. Po ashtu, në llogarinë e babait të subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank”, në datën 19.2.2013, është kryer një depozitim *cash* nga vetë ai në shumën 17.000 euro, me përshkrimin “kapar për kontratë shitje”.
12. Në vijim të hetimit administrativ, Komisionit i ka rezultuar se kjo pasuri ishte blerë më herët nga prindërit e subjektit me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 6.12.2007, kundrejt çmimit 1.900.000 lekë<sup>11</sup>, të likuiduar totalisht përpara nënshkrimit të kontratës. Gjithashtu, ASHK-ja ka bërë me dije se në datën 16.4.2013 për apartamentin e shitur në vitin 2013 nga prindërit e subjektit të rivlerësimit është paguar tatimi për kalimin e të drejtës së pronës në masën 685.000 lekë, shumë kjo që përkon me diferencën midis çmimit të shitjes prej 65.000 euro dhe çmimit të blerjes prej 1.900.000 lekësh, të shënuar në kontratën e shitjes.
13. Nga sa më lartpërshkruar, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar nga Komisioni ka rezultuar një mospërputhje midis përmbajtjes së kontratës së shitblerjes me kusht të datës 20.2.2013, në të cilën palët kanë deklaruar se kësti i parë në shumën 1.750.000 lekë do të likuidohej me nënshkrimin e kontratës, krahasuar me veprimin bankar të ndodhur në datën 19.2.2013 dhe në një shumë më të lartë, prej 17.000 euro. Për një qartësim të situatës së konstatuar, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të informonte mbi burimin e ligjshëm të shumës 17.000 euro të depozituar nga babai i tij. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka bërë me dije se shuma prej 17.000 euro (nga e

<sup>9</sup>Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se ka banuar në apartamentin në pronësi të prindërve, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë. Kjo pasuri është deklaruar si adresë banimi në vitet 2011 dhe 2012 dhe është përdorur deri në muajin maj të vitit 2013, kur është transferuar në apartamentin e ri. Për të provuar sa më sipër, ai ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. \*\*\*, datë 25.1.2017, ku kanë deklaruar se ata e kanë blerë me të ardhurat nga puna e tyre dhe se me pëlqimin e tyre kjo pasuri prej 2 vjetësh i është dhënë në përdorim djalit të tyre.

<sup>10</sup>Nga analizimi i dokumentacionit të administruar nga BKT-ja, ka rezultuar se shtetasve N. dhe S. H. u është miratuar nga një kredi me limit 3.500.000 lekë/secili, në total 7.000.000 lekë për blerjen e apartamentit të sipërcituar.

<sup>11</sup>Nga shqyrtimi i llogarive bankare të babait të subjektit pranë “ABI Bank” ka rezultuar transferimi në datën 12.11.2007, në llogari të znj. D. Ç. i shumës 64.000 euro, të krijuar nga depozitimi *cash* nga babai i subjektit i shumës 25.000 euro dhe disbursimi në datën 12.11.2007 i kredisë në shumën 40.000 euro. Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 30.10.2007, në të cilën pala shitëse ka deklaruar se shuma e shitjes së apartamentit është 65.000 euro dhe kontratën e kredisë bankare për shumën 40.000 euro, të lidhur ndërmjet “Emporiki Bank” dhe z. E. V. në cilësinë e kredimarrësit.

cila është transferuar shuma prej 15.750 euro për blerjen e apartamentit të ri, në përdorim nga subjekti), ka pasur si burim krijimi:

- a) këstin e parë nga shitja e apartamentit 1.750.000 lekë;
- b) të ardhurat e vitit 2013 të prindërve;
- c) të ardhurat nga shitja e automjetit<sup>12</sup> të babait të tij në shumën 7.000 euro.

14. Në vijim, Komisioni ka analizuar burimet e të ardhurave të sipërcituara, nga ku ka rezultuar se përgjatë periudhës janar – 19.2.2013, familja e subjektit të rivlerësimit<sup>13</sup> ka pasur të ardhura nga punësimet, pensionet përkatëse dhe aktiviteti, në shumën totale 267.711 lekë. Po ashtu edhe për sa i përket të ardhurave nga shitja e automjetit ka rezultuar se automjeti është shitur me një çmim prej 7.000 euro, ndërkohë që babai i subjektit<sup>14</sup> e kishte blerë në vitin 2009 me një çmim prej 250 euro dhe paguar zhdoganim në vlerën 284.605 lekë. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se çmimi real i blerjes ka qenë në fakt 9.000 euro, por për shkak të marrëdhënieve familjare me shitësin, babai nuk i ka kushtuar rëndësi vlerës në kontratë.
15. Përpos mospërputhjeve të mësipërme, Komisioni vlerëson se edhe nëse do të konsideroheshin si të ardhura me burim të ligjshëm financiar nga ky transaksion, vetëm shuma e barabartë me çmimin e përshkruar në kontratën e shitblerjes prej 250 euro dhe tarifën e zhdoganimit të mjetit – ndonëse është shitur 7.000 euro – sërisht do të rezultonte një mundësi financiare e prindërve të subjektit për pagesën e këstit të parë me burime të ligjshme, sikurse është pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 1 – Analizimi i burimeve për blerjen e apartamentit

Të ardhura nga shitja e apartamentit (kësti I)	1 750 000
Të ardhura nga shitja e apartamentit (kësti II)	6 895 310
Kredi bankare tek OTP Bank (80.000 Euro)	11 216 800
Të ardhura nga shitja e automjetit M. Benz	319 535
Të ardhura nga pagat dhe pensionet (janar-shkurt 2013)	267 711
Shpenzime jetese 5 persona (janar-shkurt 2013)	- 117 520
Shpenzim për blerje apartamenti (145.000 Euro)	- 20 330 450
<b>Rezultati deri në 19.2.2013</b>	<b>1 386</b>

### 1.1.2. Analizimi i burimeve për pagesën e këstit të dytë në masën 80.000 euro

16. “OTP Bank”<sup>15</sup>, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2017, ka informuar se kredia është përfituar nga subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij me objekt blerjen e apartamentit në analizë. Nisur nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite, por edhe nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare në llogarinë e kredisë, ka rezultuar se kredia është shlyer pjesërisht gjatë periudhës maj 2013 – 2016, në shumën totale 65.214 euro<sup>16</sup>, shumë kjo që përmban shlyerje të principalit dhe të interesave, përkatësisht si në vijim:

<sup>12</sup>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se automjetit tip “Mercedes-Benz” me targa \*\*\*, në pronësi të babait të subjektit, i është shitur nëpërmjet kontratës nr. \*\*\*, datë 4.12.2012, z. G. Sh., kundrejt çmimit 7.000 euro.

<sup>13</sup>Familja ka qenë e përbërë nga dy prindërit, dy gjyshërit dhe vëllai.

<sup>14</sup>Në DIPP përpara fillimit të detyrës së babait të subjektit, ky i fundit e ka deklaruar këtë automjet me vlerën 9.000 euro.

<sup>15</sup>“OTP Bank” (ish – SGA), me vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017, si dhe me përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 17.8.2020.

<sup>16</sup>Nga të cilat vetëm shuma prej 1.760 euro janë depozitime të kryera nga subjekti i rivlerësimit, të gjitha depozitimet e tjera për pagesat e kësteve janë kryer nga prindërit e subjektit. Në DIPP/2014, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar me burim nga

- a) viti 2013 është shlyer shuma 4.757 euro;
  - b) viti 2014 është shlyer shuma 7.110 euro;
  - c) viti 2015 është shlyer shuma 50.372 euro;
  - d) viti 2016 është shlyer shuma 2.975 euro.
17. Në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se pjesa e mbetur e principalit të kësaj kredie ka qenë në shumën 28.872 euro. Referuar lëvizjeve bankare të llogarisë së kredisë duket se përveç shlyerjeve të kësteve të kredisë, gjatë vitit 2015 është shlyer përpara kohe edhe një pjesë e principalit prej 46.000 euro. I pyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se për shlyerjen e kredisë, përveç të ardhurave të familjes ka shërbyer edhe një shumë prej 35.000 euro, e përfituar prej prindërve të tij nga shitja e një tjetër apartamenti në pronësi të tyre, në Vlorë.
18. Lidhur me apartamentin e shitur, të ndodhur në qytetin e Vlorës, ka rezultuar se nga vlerësimi i DIPP-së së vitit 2010 të babait të subjektit të rivlerësimit, z. E. V., ky i fundit ka deklaruar pronësinë mbi një apartament me sipërfaqe 75.8 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Vlorë, blerë kundrejt shumës 35.000 euro nga shoqëria shitëse “\*\*\*\*” sh.p.k., me burim nga të ardhurat nga avokatia. Apartamenti ishte blerë nga nëna e subjektit, znj. V. V., me anë të një kontrate kapari nr. \*\*\*, datë 16.8.2005. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur tre mandate të lëshuara nga Banka Popullore për likuidim të çmimit të këtij apartamenti, përkatësisht:
- a) në datën 11.1.2006 shuma 13.000 euro;
  - b) në datën 1.9.2006 shuma 6.000 euro dhe;
  - c) në datën 20.8.2007 shuma 7.200 euro<sup>17</sup>.
19. Për këtë pasuri, prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë nënshkruar kontratën e shitjes me datë 2.3.2015, me nr. \*\*\*, ku janë shprehur se çmimi i shitjes është likuiduar sipas kushteve të kontratës së kaparit në vitin 2005<sup>18</sup>. Më tej, ka rezultuar se kjo pasuri është shitur, provuar edhe nga lëvizjet e llogarisë bankare të nënës së subjektit pranë “OTP Bank”, ku në datën 8.5.2015 i është transferuar nga llogaria e noterës, shuma 35.000 euro me përshkrimin “kalim te shitësi nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., blerësi Sh. S., shitësi V. V.”. Më tej, nga kjo shumë është transferuar fillimisht shuma 15.000 euro në llogarinë e kredisë me përshkrimin “për ulje të detyrimit të kredisë” në datën 14.5.2015, si dhe 20.000 euro të tjera në datën 31.8.2015, me përshkrimin “për likuidim kredie”.
20. Me qëllim kryerjen e një hetimi të gjithanshëm dhe gjithëpërfshirës, Komisioni ka analizuar gjithashtu mundësinë e prindërve të subjektit të rivlerësimit, për shlyerjen e kësteve të kësaj kredie, nga ku ka rezultuar se këstet e kredisë janë paguar me burime të ligjshme financiare, sikurse është përshkruar në tabelën vijuese.

---

kursimet e tij nga paga në masën 200.000 lekë, të cilat referuar DIPP/2016, dorëzuar më 24.3.2017, rezulton se janë pakësuar. Në deklaratën *Vetting* të dorëzuar prej tij më 28.1.2017, nuk rezulton të ketë deklaruar gjendje *cash* në banesë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ai ka bërë me dije se gjendjen e disponuar *cash* jashtë sistemit bankar e ka pakësuar gjatë vitit 2016, fakt ky i deklaruar edhe në DIPP të atij viti, duke ia dhënë prindërve të tij me qëllim pagesën e kësteve të kredisë.

<sup>17</sup>Subjekti ka deklaruar se për pjesën tjetër të çmimit, prindërit nuk mund ta përcaktojnë kohën, pasi nuk kanë ruajtur dokumentacion.

<sup>18</sup>Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur librezën e ujit dhe librezat e energjisë elektrike për këtë pasuri.



Tabela nr. 2 – Analizimi i burimeve për shlyerjen e kredisë nga prindërit e subjektit

Të ardhura nga shitja e apartamentit në Vlorë (2015)	4 817 750
Të ardhura nga paga mars 2013 - 2016	2 915 368
Të ardhura nga pensionet mars 2013 - 2016	2 483 714
Të ardhura nga aktiviteti PF mars 2013 - 2016	1 910 529
Shpenzime jetese 4 persona mars 2013 - 2016	- 3 305 064
Shuma totale e shlyer prej prindërve nga kredia (2013 - 2016)	- 8 758 472
<b>Rezultati</b>	<b>63 826</b>

### 1.1.3. Shpenzime për mobilimin e apartamentit në analizë

21. Për sa i takon shpenzimeve të mobilimit të apartamentit në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, nga shqyrtimi i DIPP-së, pas largimit nga funksioni të babait të subjektit, z. E. V., në vitin 2013, ky i fundit ka deklaruar kryerjen e shpenzimeve për mobilim e pajisje në shumën 3.011.500 lekë, shpenzim ky që nuk është deklaruar prej subjektit në DIPP-në e tij të atij viti apo në vijim. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se nuk e ka konsideruar se duhet të deklaronte këtë shpenzim, pasi nuk ka menduar se ka pasur detyrimin për deklarimin e shpenzimeve të kryera nga prindërit e tij.
22. Ndërsa lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 3.011.500 lekësh, subjekti ka bërë me dije se kanë shërbyer të ardhurat e familjes së tij, si dhe tërheqjet nga llogaritë bankare të babait të tij, burim ky që është deklaruar edhe nga babai i subjektit në DIPP-në e vitit 2013. Në mbështetje të deklarimeve të mësipërme, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur lëvizjet e llogarive bankare të babait të tij, përkatësisht:
  - a) tërheqje të kryer në datën 28.6.2013, në shumën 11.042 USD;
  - b) transfertë bankare në datën 16.4.2013, në favor të shoqërisë “\*\*\*”<sup>19</sup> sh.p.k., në shumën 800.000 lekë, me përshkrimin “arredim banese”;
  - c) tërheqjet *cash* nga kjo llogari në shumën 850.000 lekë, gjatë harkut kohor 22.4.2013 – 27.8.2013.
23. Nga analizimi i llogarive bankare të mësipërme, ka rezultuar se depozita në BKT është çelur në datën 23.6.2008, në shumën fillestare prej 10.000 USD, e shtuar me interesat ndër vite, ndërsa depozita në “Intesa Sanpaolo Bank” është çelur në datën 14.4.2008, në shumën fillestare 1.300.000 lekë, shtuar me interesat ndër vite dhe e maturuar në datën 16.4.2013, në vlerën 1.861.334 lekë.
24. Në vijim të sa më sipër, duke mbajtur në vëmendje rrethanat faktiko-ligjore, Komisioni nuk shikon arsye për t’u thelluar më tej me hetimin mbi burimet e ligjshme të kursimeve të babait të subjektit të rivlerësimit, që kanë shërbyer më pas për kryerjen e shpenzimeve të mobilimit të banesës së tyre, për sa kohë:
  - a) këto shpenzime janë deklaruar prej babait të subjektit në DIPP-në e tij duke përcaktuar edhe burimet e përdorura;
  - b) ka rezultuar e provuar se së paku një shumë prej 800.000 lekësh është transferuar nga babai i subjektit në favor të një shoqërie mobilimi për arredim banese;

<sup>19</sup>Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë marrëdhënie shoqërore/familjare, si dhe nuk ka pasur konflikt interesi me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. dhe/apo ortakët/administratorët e saj, duke paraqitur shkresat nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër.

- c) nuk duket të ketë pasur kontribut nga subjekti në këto kursime, për sa kohë në periudhën e krijimit të tyre në vitin 2008, ai ende nuk kishte filluar Shkollën e Magjistraturës.
25. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të përshkruara më sipër, trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika për sa i përket burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, në përdorim dhe zotërim nga subjekti i rivlerësimit.

## **2. Automjet tip “BMW” në pronësi të subjektit të rivlerësimit**

26. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2011, si dhe më pas në deklaratën *Vetting*, duke bërë me dije se kjo pasuri është përfituar nëpërmjet kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 5.10.2011, nga pala shitëse S. A.<sup>20</sup>. Në këtë deklaratë subjekti ka deklaruar si vlerë të automjetit shumën 6.700 euro, me burim krijimi nga të ardhurat e familjes, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar vlerën 5.000 euro, me burim krijimi dhuratë nga prindërit.
27. Për sa i takon mospërputhjes ndërmjet çmimit të deklaruar në dy deklaratat, Komisioni iu drejtua subjektit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i cili ka sqaruar se në DIPP-në e vitit 2011 ai ka deklaruar si vlerë të automjetit shumën prej 6.700 euro, të përbërë nga çmimi prej 5.000 euro dhe detyrimet doganore të paguara në vlerën 245.909 lekë (rreth 1.700 euro).
28. Komisioni ka administruar dosjen e plotë të automjetit të përcjellë nga DPSHTRR-ja<sup>21</sup>, ku ka rezultuar se çmimi i përshkruar në kontratën e shitblerjes së mjetit ka qenë 5.000 euro si dhe se për të është paguar tarifa e zhdoganimit në vlerën 245.909 lekë.

### **2.1 Analizimi i burimit të ligjshëm për blerjen e automjetit**

29. Bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 25.1.2017, të lëshuar nga prindërit e tij, në të cilën kanë pohuar se të gjitha shpenzimet e nevojshme që lidhen me blerjen e automjetit janë përballuar nga të ardhurat e tyre dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se si burim për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer edhe të ardhurat e familjes në vitin 2011<sup>22</sup>.
30. Komisioni ka kryer analizën financiare të familjes për harkun kohor 2.7.2011<sup>23</sup> – 5.10.2011, periudhë kur është blerë automjeti nga ana e subjektit të rivlerësimit, ku janë përfshirë të ardhurat e prindërve të subjektit nga pagat e tyre, të ardhurat e gjyshërve të subjektit nga pensionet e tyre, si dhe të ardhurat

---

<sup>20</sup>Referuar përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë marrëdhënie shoqërore apo familjare, si dhe nuk ka asnjë konflikt interesi me shtetasin S. A., duke bashkëlidhur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2022, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2022, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër. Komisioni iu drejtua gjykatave në fjalë, të cilat me anë të shkresave, përkatësisht, nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2021; nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2022; dhe nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2021, kanë bërë me dije se subjekti i rivlerësimit nuk ka shqyrtuar asnjë çështje të gjykuar me shtetasit e përmendur në kërkesat respektive.

<sup>21</sup>Referojuni shkresave kthim – përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.10.2017, si dhe nr. \*\*\* prot., datë 14.8.2020. Gjithashtu dhe AMF-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.8.2020, ka konfirmuar mbulimin me sigurim për periudhën/at përkatëse.

<sup>22</sup>Subjekti i rivlerësimit ka listuar përkatësisht: të ardhurat e babait në shumën 1.255.181 lekë; të ardhurat e nënës në shumën 587.272 lekë; të ardhurat e vëllait në shumën 129.779 lekë; të ardhurat e tij në shumën 485.900 lekë; të ardhurat e gjyshërve në shumën rreth 665.000 + 150.396 lekë; si dhe të ardhurat nga shitja e automjetit në shumën 4.000 euro.

<sup>23</sup>Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, si dhe nga deklaratimet e babait të subjektit ka rezultuar se gjatë vitit 2011, prindërit e subjektit kanë kryer një pagesë 10.000 euro për porositjen e një apartamenti, e cila referuar mandatpagesës është kryer në datën 1.7.2011 nga nëna e subjektit në arkën e shoqërisë shitëse. Për pasojë, Komisioni ka kryer analizën financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit për harkun kohor 2.7.2011 – 5.10.2011, kur është blerë pasuria në fjalë.

nga aktiviteti i avokatisë<sup>24</sup> së vëllait të tij për një periudhë 3-mujore, si dhe shpenzimet e jetesës së tyre për të njëjtën periudhë.

31. Përveç të ardhurave të lartpërmendura, subjekti ka sqaruar se një ndër burimet është edhe një shumë prej 4.000 euro, e përfituar nga babai i tij nga shitja e një automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, me anë të kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 8.9.2011. Referuar deklarimit të babait të subjektit në DIPP para fillimit të detyrës në vitin 2010, ky automjet ishte blerë në datën 20.8.2004, kundrejt vlerës 9.000 euro, informacion i cili konfirmohet edhe nga DPRTSHRR-ja<sup>25</sup>.
32. Nga përpunimi i të dhënave mbi të ardhurat e familjes së subjektit ka rezultuar një mjaftueshmëri e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e automjetit në analizë, sikurse është pasqyruar në tabelën vijuese.

Tabela nr. 3 – Analizimi i burimeve për blerjen e automjetit

Të ardhura nga pagat korrik - shtator 2011	640 300
Të ardhura nga pensionet korrik - shtator 2011	205 670
Të ardhura nga aktiviteti PF korrik - shtator 2011	25 445
Të ardhura nga shitja e automjetit të babait	553 200
Shpenzime jetese 5 persona korrik - shtator 2011	- 170 775
Dhuruar subjektit për blerjen e automjetit	- 937 409
<b>Rezultati</b>	<b>316 430</b>

33. Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarimin e pasurisë në analizë, si dhe me ligjshmërinë e burimeve financiare.

### 3. Automjet tip “Volkswagen Polo”, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit

34. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar automjetin tip “Volkswagen Polo”, me targa \*\*\*, të blerë prej saj me anë të faturës tatimore nr. \*\*\*, datë 28.12.2012, të dhuruar nga prindërit e saj. Ajo i ka bashkëngjitur deklaratës *Vetting* deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 25.1.2017, të lëshuar nga prindërit M. dhe N. Xh., në të cilën janë shprehur se të gjitha shpenzimet për këtë automjet janë përballuar prej tyre. Për të provuar burimin e krijimit për blerjen e automjetit ai ka paraqitur lëvizjet e llogarisë së pagës së nënës së saj, znj. N. Xh.<sup>26</sup>.
35. Në vijim të hetimit administrativ, DPSHTRR-ja, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 11.8.2017 dhe datë 11.10.2017, si dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.8.2020, ka konfirmuar se në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. Xh.Xh., figuron i regjistruar automjeti me të dhënat e sipërpërmendura, i përfituar me anë të faturës tatimore të lëshuar nga shoqëria shitëse “\*\*\*\*” sh.p.k., kundrejt çmimit 145.819 lekë.
36. Ndërkohë, nga lëvizjet e llogarive bankare të pagës së prindërve të bashkëshortes ka rezultuar se nëna e saj ka tërhequr nga llogaria përgjatë vitit 2012, shumën 2.257.500 lekë, ndërsa babai nuk e ka tërhequr pagën e tij. Komisioni ka përlllogaritur edhe shpenzimet e jetesës për 3 persona për të gjithë

<sup>24</sup>Nga certifikata familjare e depozituar konstatohet se ata janë pjesë e të njëjtit trung familjar deri në vitin 2016, kur subjekti është shkëputur dhe ka lidhur martesën.

<sup>25</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2022.

<sup>26</sup>Nga shqyrtimi i informacionit të përcjellë nga ISSH-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2020, ka rezultuar se përgjatë vitit 2012, nëna e bashkëshortes së subjektit ka qenë e punësuar pranë Drejtorisë Arsimore, ndërsa babai i saj pranë ALUIZNI-t.

vitin, pas të cilave ka rezultuar se mund t'i dhuronin vajzës së tyre shumë 145.819 lekë për blerjen e automjetit në analizë, me burime të ligjshme financiare.

Tabela nr. 4 – Analizimi i burimeve për blerjen e automjetit të bashkëshortes

Të ardhura nga pagat janar - dhjetor 2012	2 257 500
Shpenzime jetese 3 persona 2012	- 423 072
Dhuruar b/sh subjektit për blerjen e automjetit	- 145 819
<b>Rezultati</b>	<b>1 688 609</b>

37. Trupi gjykues, në përfundim, ka vlerësuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me pasurinë e automjetit tip “Volkswagen Polo”, në pronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, për sa kohë ajo është deklaruar saktë dhe ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare.

#### **4. Llogari bankare në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij**

38. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur llogari bankare pranë “Credins Bank” – me gjendje përkatësisht 231 lekë dhe 2.108 lekë – të cilat, ndonëse në vlera të papërfillshme, nuk janë deklaruar prej tyre në deklaratën *Vetting*, ndryshe nga përcaktimet në ligjin nr. 84/2016.
39. Nga sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin e llogarisë bankare.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

40. Në lidhje me mosdeklarimin e gjendjes së likuiditeteve në llogaritë e sipërcituara, subjekti ka shpjeguar se gabimisht këto llogari janë menduar me vlerë 0 (zero) lekë dhe, për pasojë, nuk janë deklaruar shumat në fjalë.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

41. Trupi gjykues, duke marrë në konsideratë faktin se shumat e ndodhura në llogaritë e sipërcituara janë me vlera të papërfillshme, si dhe duke analizuar dhe vlerësuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, i gjen ato bindëse.

### **REZULTATET SIPAS ANALIZËS FINANCIARE**

42. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në Aneksin 1, që i bashkëngjitet këtij dokumenti, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e të cilave mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
43. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat, duke filluar nga viti 2011, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti, pranë ILDKPKI-së, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm pozitiv, siç është detajuar në tabelën vijuese.

Aneksi nr. 1 – Analiza financiare për periudhën 2011 – 2016

	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>691,492</b>	<b>-1,181</b>	<b>20,390,230</b>	<b>140,406</b>	<b>4,233</b>	<b>-201,143</b>
Automjet BMW	691,500					
Apartament në Rr. S. F., T***			20,330,450			
Ndryshim likuiditeti	-8	-1,181	59,780	140,406	4,233	-201,143
<b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>	<b>793</b>	<b>-388</b>	<b>59,392</b>	<b>199,798</b>	<b>204,032</b>	<b>2,889</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>10,433,245</b>	<b>-998,128</b>	<b>-6,935,583</b>	<b>-404,632</b>
Kredi bankare tek S. G. Albania (OTP)			10,433,245	-998,128	-6,935,583	-404,632
Kartë krediti në Credins Bank		-120,234	-120,103	-126,071	0	
<b>PASURI NETO</b>	<b>691,492</b>	<b>-1,181</b>	<b>9,956,985</b>	<b>1,138,535</b>	<b>6,939,817</b>	<b>203,489</b>
<b>Të ARDHURA dokumentuar</b>	<b>1,413,628</b>	<b>821,466</b>	<b>10,468,254</b>	<b>2,085,572</b>	<b>8,137,561</b>	<b>1,343,542</b>
Të ardhura të subjektit	476,219	821,466	807,785	1,146,835	1,198,762	1,209,425
Të ardhura të bashkëshortes						-
Dhuratë nga prindërit	937,409		9,113,650			-200,000
Shlyerje të kredisë nga ana e prindërve			546,819	938,737	6,938,799	334,117
<b>SHPENZIME</b>	<b>498,950</b>	<b>211,142</b>	<b>235,918</b>	<b>542,058</b>	<b>691,730</b>	<b>1,126,743</b>
Shpenzime jetese	136,620	141,024	141,024	219,998	224,276	626,912
Shpenzime mjekësore						143,800
Shpenzime zhdoganimi	245,909					
Shpenzime udhëtimi/transporti	116,421	56,618	80,214	305,160	451,624	356,031
Shpenzim për siguracion automjeti		13,500	14,680	16,900	15,830	
Analiza dokumentuar	223,186	611,505	275,351	404,980	506,014	13,311
Gjendje cash në banesë në lekë				200,000	200,000	0
Gjendje në llogaritë bankare	793	-388	59,392	-202	4,032	2,889
<b>DIFERENCA E PA MBULUAR</b>		<b>0</b>				

**B. KONTROLLI I FIGURËS**

44. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit raporti me nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit – pa përgjigjen e njërit prej tre autoriteteve verifikuese – me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Edvan Veçani.
45. Me shkresën e datës 23.1.2018, DSIK-ja i ka bërë me dije Komisionit se organet ligjzbatuese nga verifikime të kryera nuk kanë disponuar të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit. Me shkresën e datës 26.4.2022, organet ligjzbatuese i kanë bërë me dije Komisionit se nga verifikime të kryera (sërish) nuk janë disponuar të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit.
46. Në vijim të kërkesës së Komisionit të datës 8.6.2022, për një përditësim dhe deklasifikim të raportit të tyre, DSIK-ja, me shkresat e datave 4.7.2022 dhe 8.7.2022 ka përcjellë në Komision dy përgjigje të fundit të autoriteteve verifikuese (27.6 dhe 5.7.2022), nëpërmjet të cilave shprehen/konfirmojnë se nuk ka të dhëna të reja për të përditësuar.

47. Gjithashtu, me shkresën e datës 12.7.2022, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se prej vitit 2017 dhe aktualisht nuk kanë rezultuar të dhëna të reja për subjektin e rivlerësimit Edvan Veçani. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.9.2022, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht në datën 8.9.2022, me vendimin nr. \*\*\* të KDZH-së.
48. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Edvan Veçani arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk ka bërë deklaratime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

49. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e KLD-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur – ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Edvan Veçani, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese – burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

#### **C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KLD-ja**

50. Raporti nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2018, i përcjellë nga KLD-ja është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, i cili ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së.
51. Sipas këtij raporti: (i) subjekti i rivlerësimit Edvan Veçani ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; (ii) gjyqtari, përgjithësisht, përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të së drejtës si parimi i zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, parimin e disponibilitetit të padisë etj.; (iii) gjyqtari ka njohuri akademike shumë të mira dhe i shfaq ato në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; (iv) vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej gjyqtarit Edvan Veçani janë të qarta dhe të kuptueshme.

52. Subjekti i rivlerësimit, nga janari i vitit 2014, ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila nuk ka qenë e organizuar në seksione. Gjyqtari ka gjykuar çështjet brenda afateve ligjore apo afatet standarde, ndërsa ka treguar kujdes edhe për arsyetimin në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore.
53. Subjekti Edvan Veçani ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore, po ashtu një tipar i mirë i punës së tij është zhvillimi i seancave në sallë gjykimi dhe dokumentimi i tyre me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe të solemnitetit.
54. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht, është konstatuar se gjyqtari ka aftësi për të administruar dosjet dhe në çdo dosje të vëzhguar gjyqtari ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.
55. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk janë konstatuar të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Edvan Veçani edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

### **C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni**

56. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e përpiluar nga ky institucion, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet publike të administruara për këtë qëllim.
57. Komisioni, nga vlerësimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short, ka konstatuar se: në dosjen nr. 1 subjekti i rivlerësimit ka caktuar seancën gjyqësore pas 15 ditëve, pra në tejkalim të afatit 10-ditor të parashikuar në nenin 333/1 të Kodit të Procedurës Penale; në dosjen nr. 2. subjekti ka caktuar seancën gjyqësore pas 14 ditëve nga regjistrimi i çështjes, në tejkalim të afatit 10-ditor të caktuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale; dhe lidhur me dosjen nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar vendimin pas 15 ditëve nga shpallja e tij, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile, duke i kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit.

#### **Qëndrimi i subjekti të rivlerësimit**

58. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit në prapësimet e dërguara, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se seancat gjyqësore që i përkasin dosjeve nr. 1 dhe nr. 2 janë caktuar brenda 10 ditëve nga dita e ndarjes së tyre me short, ndërsa lidhur me tejkalimin e afatit ligjor për dorëzimin e vendimit që i përket dosjes nr. 3, subjekti ka shpjeguar se ka ndodhur për shkak të ngarkesës me çështje gjyqësore.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

59. Duke mbajtur në vëmendje sa më sipërshpjeguar, trupi gjykues, duke konsideruar ngarkesën gjatë tre viteve të fundit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, por edhe shpjegimet e subjektit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime, përgjithësisht, bindëse.

### **DENONCIME NGA PUBLIKU**

60. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur 4 denoncime nga publiku, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr.

84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar se nga përmbajtja e një pjese të tyre nuk janë evidentuar prova mbi shkelje të mundshme të subjektit apo *indicie* mbi të cilat të mund të kryhej ndonjë hap hetimor i mëtejshëm. Ndërsa mbi disa të tjerë janë kryer hetime të thelluara dhe janë administruar dokumente dhe informacione shtesë, disa prej të cilave janë trajtuar në vijim:

### **1. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2018, nga shtetasi L. K.**

61. Shtetasi L. K. ka denoncuar subjektin e rivlerësimit dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë për shkelje ligjore, duke pretenduar se nga subjekti i rivlerësimit ai, padrejtësisht, është bërë palë në proces gjyqësor dhe se nuk janë marrë për bazë provat e depozituara nga ky i fundit. Ky denoncim është bërë publik edhe në median *online*, ku veç të tjerash shprehej se: “[...] *familja K. ka rreth 5 vjet që nuk po zgjidh dot një problem, që i ka lindur me përmbarrimin shtetëror, pasi ai nuk po ekzekuton një vendim të montuar të formës së prerë për L. K., të cilit i kërkohet prishja e 55m<sup>2</sup>, ndërkohë që ky i fundit nuk ka asnjë pronë apo pasuri në emër të tij. Djali i L. sqaron se përmbarruesi, policia dhe bashkia në Peshkopi janë bërë bashkë, për të prishur shtëpinë e gjyshit të tij Z. K., sepse gjyqi është zhvilluar në emrin e babait të tij, por me numrin e pasurisë së gjyshit të tij. Strumbullar është bërë një vendim gjykate nga Edvan Veçani, i lënë në fuqi nga Apeli*”.
62. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 8.10.2015, duke vendosur “Pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e të paditurit të lirojë dhe t’i dorëzojë palës paditëse sipërfaqen e zënë prej 55 m<sup>2</sup>, pasuri e paluajtshme me emërtimin ‘\*\*\*’ Peshkopi”, vendim i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.3.2017, vendim i cili ka marrë formë të prerë. Nga analizimi i ankimit të denoncuesit ka rezultuar se denoncimi përmban të njëjtat shkaqe dhe pretendime si në denoncimin e lartpërmendur.
63. Nisur nga sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë kryesisht me themelin e çështjes dhe vendimmarrjen, për të cilat është shprehur me anë të vendimit Gjykata e Apelit Tiranë, vendim i cili ka marrë formë të prerë dhe se nuk janë konstatuar shkelje procedurale, etike apo mangësi profesionale nga ana e subjektit të rivlerësimit.

### **2. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 26.10.2018, i shtetasit Sh. D.**

64. Shtetasi denoncon drejtuesit e Prokurorisë dhe drejtuesit e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, por nuk ka specifikuar ndonjë rrethanë konkrete, shkelje ligjore apo procedurale të kryer nga subjekti i rivlerësimit duke i bashkëlidhur vendimin për lëshim të urdhrit të ekzekutimit nr. \*\*\*, datë 3.6.2014, me objekt “lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin civil nr. \*\*\*, datë 28.12.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë”, marrë nga subjekti i rivlerësimit Edvan Veçani, me palë kërkuese L.D.”<sup>27</sup>. Ky denoncim është bërë edhe publik në median *online* ku, veç të tjerash, përshkruhej se: “[...] *Një skandal në Gjykatën e Dibrës, ku gjyqtari Edvan Veçani ka gjykuar një vendim në shkallën e parë që ishte i formës së prerë nga Gjykata e Lartë. Sipas dokumenteve që disponon emisioni investigativ, z. Veçani lëshoi një urdhër ekzekutimi për një vendim të 2004-ës të ish-gjykatës së Bulqizës, që ishte ndryshuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Në redaksinë e ‘\*\*\*’ u ankua z. Sh. D., i cili*

<sup>27</sup>Denoncuesi Sh. D. më herët kishte kallëzuar në Prokurorinë e Rrethit Dibrë në datën 1.8.2002, falsifikimin e një kontrate shitjeje të vitit 1993, e cila është bërë më pas objekt gjykimi.



*thotë se familja e tij ka trashëguar një truall të trashëguar në Bulqizë. Z. D. thotë se në vitin 2004 ish Gjykata e Bulqizës, e cila më pas u shkri dhe u transferua në Gjykatën e Dibrës, i dha të drejtë familjes së tij. Nga kjo gjykatë ai mori një vendim me një shënim nga mbrapa nga kancelari që ‘ishte i formës së prerë’, nuk ishte apeluar. Në vitin 2014 kërkoi nga Gjykata e Dibrës lëshimin e një urdhri ekzekutimi të këtij vendimi. Gjyqtari Edvan Veçani vendosi të pranojë kërkesën. Filluan procedurat, por në vitin 2017 një tjetër gjyqtar i Gjykatës së Dibrës vendosi që të rrëzonte vendimin e Veçanit! Sipas qytetarit, janë bërë shumë vendime të dyshimta. Fiksi i bën të njëjta pyetje edhe kancelarit: Përse nuk e verifikoi z. Veçani, ndërkohë, kancelari thotë se në 2014-ën ka qenë ai kancelar, por në dosje nuk ka asnjë kërkesë nga gjyqtari Edvan Veçani për të verifikuar nëse ka qenë apo jo i formës së prerë. Sipas kancelarit, një vendim i tillë i takon vetëm trupit gjykues”.*

65. Në kuadër të analizimit të denoncimit të lartpërmendur, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2022, ku kjo e fundit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2022 vuri në dispozicion praktikën e plotë, vendimin nr. \*\*\*, datë 3.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, “Lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit për vendimin civil nr. \*\*\*, datë 28.12.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë”, të dhënë nga gjyqtari Edvan Veçani, me palë kërkuese L. D., përfaqësuar nga z. Sh. D.<sup>28</sup>.
66. Referuar fashikullit ka rezultuar se gjyqtari, pas analizimit të bazueshmërisë në ligj të kërkesës për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit – i cili sipas shënimit në kopjen e vendimit se “vendimi ka marrë formë të prerë në datën 31.1.2005, pasi ndaj tij nuk është ushtruar ankim” – fakt ky që vijohet në arsyetimin e vendimit të Gjykatës – “... i provuar nga shënimi i kryesekretarisë së gjykatës”, ka vijuar me marrjen e vendimit për “Pranimin e kërkesës, lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 28.12.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë”. Nga kopja e vendimit të vënë në dispozicion konstatohet se në faqen e fundit të vendimit të vitit 2004 nga ish - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë, ky vendim rezulton: (i) të jetë i vulosur me vulën e ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë; (ii) të jetë shënuar me shkrim dore “ky vendim ka marrë formë të prerë datë 31.1.2005, nga kancelarja R. M.”; si dhe (iii) të jetë aplikuar pulla e taksës 100 lekë dhe evidentohet të ketë edhe një vulë noterie.
67. Në datën 14.2.2017 pala kreditore, familja D., rezulton të ketë depozituar në Zyrën e Përmbarimit Dibër kërkesën për ekzekutimin e tij ndaj debitorës, znj. V. S., kjo e fundit, duke mos qenë dakord me vendimin e datës 3.6.2014, ka ngritur padi në vitin 2017 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër duke kërkuar: “Pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv të vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 28.12.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, si një detyrim që nuk ekziston, pasi vendimi për të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr. \*\*\*, datë 3.6.2014, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër nuk ekziston”. Pjesë e dokumentacionit të depozituar nga paditësja në cilësinë e provës ka qenë edhe një kopje e vendimit nr. \*\*\*, datë 28.12.2004, me shënimin vendimi i vitit 2004 është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.11.2005, duke vendosur “Ndryshimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 28.12.2004” dhe pas rekursit në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.11.2007,

<sup>28</sup>Rrethanat e çështjes, shtetasja V. S. ka privatizuar objektin dyqan, të cilin më pas e ka shitur. Më parë për këtë pasuri kjo shtetase ka qenë palë ndërgjyqëse me shtetasin N. D. – L. Sh. D., fëmijët e të ndjerit, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë ka nxjerr vendimin e vitit 2004. Pas marrjes së njoftimit për vendimin e vitit 2004, shtetasja V. S. ka ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka ndryshuar këtë vendimin.

kishte vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga paditësi N. D.<sup>29</sup>, duke lënë kështu përfundimisht në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë të vitit 2005.

68. Referuar kërkesëpadisë së ngritur në vitin 2017 nga kreditorja me objekt “Pavlefshmëri të titullit ekzekutiv”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.7.2017, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë dhe deklarimin e pavlefshëm të titullit ekzekutiv vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, datë 28.12.2004, pasi ky titull ekzekutiv nuk ekziston”*. Nga shqyrtimi i vendimit të vitit 2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër nuk konstatohet që gjyqtari i çështjes të jetë ndalur apo shprehur se e kujt është përgjegjësia dhe nëse ka shkelje ligjore apo procedurale të vendimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit, qoftë edhe lidhur me administrimin dhe/apo pranimin e kërkesës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit gjatë zhvillimit nga subjekti i rivlerësimit.
69. Duke mos qenë dakord me vendimin e vitit 2017 të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, vendimi është ankimuar nga familja D. në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nga sa më lart, Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.3.2022, ka informuar se kjo çështje është regjistruar me nr. regj. themeli \*\*\*, datë 24.7.2017, nr. \*\*\* dhe se çështja është në status përpunimi.
70. Referuar pretendimeve të ngritura në denoncimin mediatik për shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit, Komisionit i rezulton se për sa i takon vendimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit, bazuar mbi kopjen disponibël të vendimit të vitit 2004, e cila rezulton të jetë: (i) vulosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë – si organi që e ka lëshuar atë; (ii) firmosur nga kancelarja e ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë; dhe se (iii) dispononte shënimin “vendimi ka marrë formë të prerë në datën 31.1.2015”, të dhëna këto të cilat krahasuar me kopjen e po të njëjtit vendim të paraqitur nga paditësja V. S., nuk përputhen pasi – në kopjen e paraqitur nga kreditorja në gjykim figuron shënimi – vendimi nr. \*\*\*, i vitit 2004, është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2005, duke vendosur “Ndryshimi i vendimit të vitit 2004”.
71. Komisioni vëren se, fillimisht, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, mbështetur mbi një vendim civil të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, si dhe në nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile<sup>30</sup> ka lëshuar titullin ekzekutiv që vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrin, i cili për rastet e parashikuara nga germat “a” të nenit 510 të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin. Në këtë rast, kancelari konfirmon urdhrin e ekzekutimit brenda pesë ditëve nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor.
72. Në këto kushte, nisur nga shënimi mbi vendimin nr. \*\*\* të vitit 2004 se vendimi kishte marrë formë të prerë më 31.1.2005 dhe se i ishte konfirmuar nga kancelaria e ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar kërkesën civile duke e gjetur të drejtë atë. Duket se këto elemente procedurale, por edhe formale kanë induktuar gjyqtarin që të marrë vendimin për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të vitit 2014, pikërisht duke u bazuar mbi një dokument, i cili kishte vulën e institucionit, pullën si dhe shënimin e bërë nga kancelarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, si më lart, por që nuk rezulton të kishte së paku një konfirmim apo shënim nga kancelaria aktuale e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila në momentin e shqyrtimit të kësaj kërkesë në vitin 2014 ishte edhe gjykata kompetente (për sa i përket kompetencës tokësore dhe asaj lëndore – pas mbylljes

---

<sup>29</sup>N. D., babai i shtetasit L. D.

<sup>30</sup>Me ndryshimet e ligjit nr. 122/2013, Kodi i Procedurës Civile ka ndryshuar edhe dispozitën përkatëse.

së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë) që e kishte pranuar dhe që po e shqyrtonte aktualisht vendimin e vitit 2004.

73. Po ashtu, në Kodin e Procedurës Civile, neni 511/1 citohet se urdhri i ekzekutimit lëshohet së bashku me vendimin gjyqësor dhe bëhet i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor vetëm pas konfirmimit nga kancelari, i cili konfirmon urdhrin e ekzekutimit pasi verifikon se vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë sipas shënimit të posaçëm në urdhrin e ekzekutimit. Nga sa më sipër, duket se edhe nga ana e kancelarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, për sa i takon procedurës administrative të ndjekur për këtë vendim, nuk është përmbushur së paku detyrimi administrativ ligjor për sa kohë edhe ka filluar ekzekutimi i vendimit, provuar kjo nga fakti se ka qenë në Zyrën e Përmbarimit Dibër, e cila është investuar për fillimin e procedurës së ekzekutimit.
74. Duke analizuar sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se duke qenë se vendimi për të cilin kërkohet lëshimi i urdhrin të ekzekutimit, i përkiste vitit 2004, për rrjedhojë, kërkesa për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit duhet t'i nënshtrohet gjykimit normal, sikurse parashikonin dispozitat e mëparshme. Nisur nga një vështrim më i gjerë dhe i përgjithshëm dhe pa dashur të paragjykohej themeli i vendimmarrjes dhe logjika e gjyqtarit, por edhe duke mos shmangur përgjegjësitë/në edhe administrative të administrimit, Komisioni e gjen të paqartë, jobindëse dhe joshteruese procedurën ligjore mbi të cilën fillimisht është pranuar kërkesa nga kancelaria aktuale e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër<sup>31</sup> “... e cila ka pasur për detyrë fillimisht të kryejë kontrollin për pranimin (fizikisht) e kërkesës civile, verifikimin e saj së paku nga ana formale ...” po ashtu edhe – verifikimin dhe lëshimin e një kopjeje të vendimit gjyqësor të formës së prerë të njëzuar me origjinalin, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore.
75. Përtej faktit të një mungese të shtuar të kujdesit në ushtrimin e detyrës funksionale administrative dhe jo vetëm nga ana e kancelarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër – në pranimin e kërkesës civile për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, si dhe në mosevidentimin dhe mosverifikimin nëse *ky vendim kishte marrë formë të prerë – që prej vitit 2005*, gërshetuar kjo me disa faktorë e rrethana konkrete objektive siç ka qenë periudha e tejzgjatur që prej vitit 2005, por edhe faktit se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë ishte mbyllur dhe se të gjitha çështjet e shqyrtuara kanë qenë transferuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Duket se fillimisht, ka munguar miradministrimi dhe mirëmenaxhimi i dokumentacionit nga personat përgjegjës të ngarkuar për këtë procedurë dhe po ashtu, duke mos lënë mënjanë edhe faktin se subjekti i rivlerësimit që ka gjykuar kërkesën e cila nuk ishte sigluar së paku nga kancelaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, duhet minimalisht të kishte kryer verifikimin e vendimit – duke u nisur së paku nga koha e largët kur ishte dhënë ky vendim.
76. Nga sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me vendimin për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit mbi kopjen e vendimit, i cili referuar vendimit të vitit 2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër rezultoi e provuar se vendimi nr. \*\*\*, viti 2004 nuk kishte marrë formë të prerë.

---

<sup>31</sup>Referuar dokumentit “Urdhër për Miratimin e rregullores së veprimtarisë administrative të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër”, miratuar më 4.6.2014, dokument i cili daton vetëm 1 ditë më pas dhënies së vendimit datë 3.6.2014 nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk mund të shmang në terma të përgjithshëm ligjorë përgjegjësinë dhe veprimtarinë që kryen kancelaria, nenet 9 dhe 10.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

77. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit lidhur me denoncimin e sipërcituar, subjekti ka shpjeguar në prapësime dhe në seancën dëgjimore se, ndonëse ka qenë në fillimet e detyrës së tij, ai nuk ka pasur asnjë arsye për të dyshuar se shënimet në vendimin nr. \*\*\*, datë 28.12.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, nuk pasqyrojnë realitetin lidhur me faktin që ky vendim kishte marrë formë të prerë dhe, rrjedhimisht, nuk kishte shkak që të verifikohet dokumenti përkatës pranë kancelarisë së gjykatës. Kancelaria kompetente duhet që të kishte njoftuar në momentin e paraqitjes së kërkesës se ky vendim nuk kishte marrë formë të prerë, pasi dosja dhe urdhri i ekzekutimit ndodhet pranë kësaj kancelarie.
78. Subjekti, gjithashtu, është shprehur se pasi është njohur nga mediat për këtë rast, është interesuar pranë kancelarisë së gjykatës, ku i është shpjeguar se ky fakt ka ndodhur për shkak se ankimi ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 28.12.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë është përcjellë nga pala e paditur nëpërmjet shërbimit postar. Ndonëse akti në fjalë është paraqitur në postë brenda afatit të ankimit, ky ankim në gjykatë ka mbërritur përtej këtij afati, konkretisht, në datën 31.1.2005. Ndërkohë që, pikërisht pas kalimit të afatit për paraqitje të ankimit dhe përpara se në gjykatë të mbërrinte/dorëzohej ankimi nga ana e shërbimit postar, pala paditëse kishte kërkuar dhe kishte marrë nga gjykata një kopje të vendimit me shënimin se: *“vendimi ka marrë formë të prerë në datën 31.1.2005, pasi ndaj tij nuk është ushtruar ankim”*.

## **Vlerësimi i trupit gjykues**

79. Trupi gjykues, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, brenda kornizës të juridiksionit administrativ dhe në zbatim të dispozitave të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, çmon se, ndonëse nga një analizë *post factum* gjendet përballë lëshimit të një urdhër ekzekutimi, konkretisht, të pabazuar mbi një titull/vendim të formës së prerë, parë në optikën e dinamikës së ngjarjeve, krijohet bindja se urdhri në fjalë është lëshuar nga subjekti duke u mbështetur *in prima face* në një vendim origjinal, mbi të cilin, nga organi kompetent ishte shënuar (gabimisht) përcaktuesi esencial: *“Ky vendimi ka marrë formë të prerë në datën 31.1.2005, pasi ndaj tij nuk është ushtruar ankim”*. Për më tepër, vlen të theksohet se vendimi dhe dosja gjyqësore në fjalë ishin lëshuar/krijuar/shqyrtuar në themel nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë dhe jo nga ajo e Rrethit Gjyqësor Dibër, ku subjekti ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit, pasi kjo praktikë ishte transferuar aty më pas, për shkak të shkrirjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë.
80. Nën dritën e kësaj dinamike faktike, duke mbajtur në vëmendje tipologjinë e procedurës dhe të aktit specifik, si dhe mosshkaktimin e pasojave/efekteve substanciale, pasuese të urdhrin *de quo* – për shkak të aktivizimit të mjeteve korrektuese brenda sistemit të drejtësisë – krijohet bindja se ndonëse urdhri në fjalë, konkretisht, ka rezultuar i pabazuar në realitetin e evoluar (pas lëshimit të kopjes së vendimit të shqyrtuar nga subjekti), për lëshimin e tij subjekti ka qenë i induktuar nga një gabim njerëzor dhe/ose neglizhencë e personelit mbështetës, që i ka paraqitur atij një realitet të ndryshëm, në padijeninë e tij. Për rrjedhojë, në konkludim e konsideratë të sa më sipër, trupi gjykues çmon se kjo rrethanë e vetme nuk mund të passjellë pasoja penalizuese lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të z. Edvan Veçani.

### **3. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019, nga shtetasi A. Ll.**

81. Shtetasi A. Ll. denoncon subjektin e rivlerësimit për mosndjekje të procedurave ligjore të njoftimit të palëve ndërgjyqëse dhe se gjykimi ishte bërë në mungesë të palëve dhe, po ashtu, padrejtësisht gjyqtari nuk u ka njohur atyre atësinë e fëmijës. Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për të vënë në dispozicion fashikullin e plotë dhe kjo e fundit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2022, përcolli vendimin dhe aktet e njoftimit të palëve ndërgjyqëse. Komisionit i ka rezultuar se gjyqtari ka marrë vendimin nr. \*\*\* , datë 5.12.2019, me objekt “zgjidhje e martesës midis paditëses I. Zh. dhe të paditurit M. Zh.”. Ky vendim është ankimuar nga palët dhe nga veprimi i kryer ka rezultuar se kjo çështje është në përpunim – sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2022, të Gjykatës së Apelit Tiranë.
82. Referuar fashikullit të dosjes gjyqësore konstatohet se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë, nga e cila ata nuk kanë pasur fëmijë. Ndërsa sa i përket pretendimit të dytë se nga ana e subjektit nuk janë ndjekur procedurat ligjore për njoftimin e palëve ndërgjyqëse, vërehet se palët janë njoftuar sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Civile, ndryshe nga sa pretendohet në denoncimin në analizë. Për rrjedhojë, lidhur me këtë denoncim, nisur nga përmbajtja dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara, Komisioni nuk ka konstatuar shkelje procedurale të subjektit të rivlerësimit, sikurse ishte pretenduar nëpërmjet këtij denoncimi.

### **4. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 13.9.2019 dhe nr. \*\*\*<sup>32</sup>, datë 27.10.2022, të shtetasës E. O.**

83. Shtetasja E. O. ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi dhe, ndërmjet tyre, edhe gjyqtarin Edvan Veçani, i cili ka marrë vendimin nr. \*\*\* , datë 10.6.2019, për deklarinimin si të “Pafajshëm të shtetasve Sh. M. dhe Q. M.” për veprën penale “shpërdorim detyre”. Denoncuesja nuk pretendon shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, kryesisht pretendimet e saj kanë të bëjnë me pakënaqësitë për vendimmarrjen.
84. Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2022, iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2022, vuri në dispozicioni vendimin nr. \*\*\* , datë 10.6.2019, nëpërmjet të cilit gjyqtari Veçani ka çmuar dhe ka vlerësuar se të pandehurit e asaj çështjeje ishin të pafajshëm. Ky vendim është ankimuar nga denoncuesja në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nga shqyrtimi dhe analizimi i vendimit Komisioni vlerëson se pretendimet e denoncueses kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit, pra me themelin e çështjes, vlerësime të cilat nuk janë objekt vlerësimi nga ky Komision.

### **5. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2022, i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.**

85. Ky denoncim, fillimisht, është paraqitur vetëm pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe është regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2021 dhe, më pas, së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur, është përcjellë edhe pranë Komisionit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2022, nga ku edhe është marrë në shqyrtim. Nga vlerësimi i dokumentacionit ka rezultuar se shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. i janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në vlerë monetare në biznes, si pasojë e reshjeve të shumta të nëntorit të vitit 2016, me pasojë ngordhjen e një sasive të konsiderueshme të troftës në rezervat. Denoncuesi pretendon se shkaktari i kësaj katastrofe kanë qenë punimet e kryera në veprën e HEC-it si pasojë e hedhjes së mbeturinave, mungesa e një studimi gjeologjik nga shoqëria “\*\*\*”, që operon

---

<sup>32</sup>Denoncimi nr. \*\*\* , datë 27.10.2022, ka të njëjtën përmbajtje me denoncimin e mëparshëm. Ky denoncim ka ardhur pas zhvillimit të seancës dëgjimore.

në fushën e rritjes së kapacitetit të energjisë elektrike, sipas kontratës koncensionare. Nisur nga humbja e sasive të mëdha të troftës, përfaqësuesi i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. ka ngritur një padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, me objekt “Dëmshpërblimi nga subjekti B.G.E. në shumën 300.000 euro. Rehabilitimi i masivit argjilor tek vepra e marrjes, me studim hidrologjik, që të japë garanci për aktivitetin e paditësit”.

86. Kjo çështje është regjistruar fillimisht në vitin 2016 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe pas disa vendimesh për vlerësimin e kompetencën tokësore të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, Tiranë dhe Gjykata e Lartë, është rikthyer për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, po me të njëjtën gjyqtare, që e ka gjykuar çështjen deri në datën 19.12.2018 – periudhë gjatë së cilës janë kryer dhe hartuar shumica e aktekspertimeve (gjeologjik, mjedisor, etj.) dhe në datën 19.12.2019, pas hedhjes së shortit, gjykimi i kësaj çështjeje i ka kaluar subjektit të rivlerësimit. Shtetasi pretendon se subjekti i rivlerësimit e ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 9.6.2021, në kundërshtim me ligjin, pasi me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.6.2021, subjekti ka vendosur rrëzimin e padisë<sup>33</sup>, si dhe ka kryer disa shkelje procedurale si: (i) nuk janë marrë në konsideratë 6 aktekspertimet nga ekspertët e thirrur nga gjykata; (ii) nuk ka marrë në konsideratë shkeljet ligjore për ndërtimin pa leje, nuk ka respektuar lejen mjedisore, nuk ka studim gjeologjik, shkelje të cilat janë bërë shkak për prishjen e mjedisit etj.; (iii) nuk ka marrë në konsideratë të gjitha provat shkresore të evidentuara edhe nga Komisioni i Mbrojtjes Civile. Në mbështetje të pretendimeve të tij denoncuesi ka bashkëlidhur edhe dy kopje të aktekspertimeve (tekniko-minerar dhe të ekspertit ing. gjeolog).
87. Nga sa më lart, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila me anë të shkresës nr.\*\*\* prot., datë 12.10.2022, përcolli praktikën/dosjen e plotë të çështjes gjyqësore në analizë, duke informuar se kjo çështje është ankimuar dhe aktualisht çështja është në Gjykatën e Apelit Tiranë.
88. Nga shqyrtimi i kësaj dosjeje është konstatuar se lidhur me pretendimin *për mosmarrjen në konsideratë të të gjitha aktekspertimeve*, gjykata<sup>34</sup> ka thirrur një numër të konsiderueshëm ekspertësh të fushave të ndryshme si: ekspertë të vlerësimit të dëmit, të peshkimit dhe akuakulturës, kontabël, gjeolog, si dhe tekniko-minerar<sup>35</sup>, për të cilët janë marrë vendimet e ndërmjetme në seancat përkatëse dhe janë lënë detyrat specifike, duke u bazuar në pyetjet që palët ndërgjyqësore kanë parashtruar për secilin ekspert. Në vijim, ekspertët kanë hartuar aktekspertimet duke parashtruar mendimin e tyre shkencor dhe profesional dhe, përgjithësisht, të shoqëruar edhe me foto nga ku pasqyrohej vendi i ngjarjes.
89. Nga analizimi i vendimit të arsyetuar të gjykatës vërehet se nga subjekti i rivlerësimit janë përshkruar në mënyrë përmbledhëse dhe sintetike të gjitha rezultatet e aktekspertimeve të administruara në dosjen

---

<sup>33</sup> “Në rastin objekt gjykimi rezulton se nuk vërtetohet lidhja shkakësore ndërmjet sjelljes së paligjshme e me faj të palës së paditur dhe dëmit të shkaktuar ndaj palës paditëse. Kështu, gjatë këtij gjykimi, nuk u provua se në datën 10.11.2016 të ketë ndodhur rrëshqitje dheu në veprën e palës së paditur, e cila të ketë dëmtuar aktivitetin e palës paditëse. Asnjë nga ekspertët e caktuar gjatë gjykimit nuk arriti në përfundimin e mësipërm, në këto kushte, ky ngeli pretendim i palës paditëse”.

<sup>34</sup> Në periudhën 2018 – 2021 janë thirrur një numër i konsiderueshëm ekspertësh nga gjykata, shumë prej të cilëve kanë paraqitur dorëheqjen për shkak të specifikave të fushës së veçantë që përmbante problematika në vetvete. Në datën 12.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka çmuar në seancë dhe me miratimin e palëve se, për vetë natyrën e çështjes dhe faktin se kjo çështje ka 2 vjet që shqyrohej, ka vlerësuar të vijojë hetimin në fazën ku ishte lënë gjykimi.

<sup>35</sup> Aktekspertime të hartuara nga ekspertët tekniko-minerar Rr. P., ekspert gjeolog I. Gj., ekspert vlerësim dëmi M. H., ekspert akuakulturës F. Gj., ekspert kontabël F. Gj.

gjqësore<sup>36</sup>, akte të cilat i janë përgjigjur detyrave dhe pyetjeve të urdhëruara nga gjykata. Referuar aktekspertimit tekniko-minerar (i cili rezultoi të jetë edhe ekspert mjedisi) të vitit 2018 është arritur në përfundimin se: “*Shkaku determinant ka ardhur si rezultat i përzierjes së ujit më dherat dhe avulionet e krijuara nga gërmimet tek vepra e HEC –it, nga subjekti \*\*\*.*” dhe po ashtu, edhe në aktin e ekspertit gjeolog, ndër të tjera, është argumentuar se: “*Shoqëria \*\*\* ka kryer punime pa studim gjeologjik dhe hidrologjik, duke ndikuar në prishjen e elementëve strukturorë e konstruktivë të tokës, etj., punë të cilat përbëjnë rrezik pasi krijojnë rrëshqitje dhe zgjerim të kontureve etj.*”.

90. Nga sa u përshkrua më sipër, rezultoi kryerja e një pasqyrimi në mënyrë të përmbledhur dhe sintetike i konkluzioneve profesionale dhe shkencore nga gjyqtari, mbi detyrat e ngarkuara ekspertëve duke arritur në përfundimin se *në asnjë nga aktekspertimet nuk është arritur në përfundimin e pakundërshtueshëm se shkaktimi i dëmit ka ardhur nga reshjet/rrëshqitjet e datës 10.11.2016*”, sipas pretendimit të denoncuesit/palës paditëse.
91. Lidhur me pretendimin se subjekti i rivlerësimit [...] *nuk ka marrë në konsideratë hetimin lidhur me shkeljet ligjore si ndërtime pa leje, pa studim gjeologjik dhe pa respektuar lejen mjedisore dhe se nuk ka marrë në konsideratë provat shkencore dhe aktet administrative të evidentuara nga Komisioni i Mbrojtjes Civile të Bashkisë Dibër*<sup>37</sup>, nga vlerësimi i dosjes gjyqësore Komisionit i ka rezultuar se aktet administrative janë pjesë e fashikullit gjyqësor, të cilat kanë evidentuar situatën konkrete në momentin e ndodhjes së përmytjes. Por, konstatohet se në këto akte nuk përcaktohet/konkludohet qartazi nëse kanë qenë pikërisht punimet e shoqërisë \*\*\* ato që kanë passjellë përmytjen e vaskave të troftës, ndërkohë që në këto akte është bërë prezent vetëm dinamika e eventit natyror (përmytje) lidhur me dëmtimin e vaskave dhe të peshkut, ndonëse ky pretendim është ngritur nga denoncuesi, që gjithashtu nuk gjen mbështetje nga analizimi i akteve.
92. Gjithashtu, denoncuesi ka pretenduar se gjyqtari *nuk ka marrë në konsideratë faktin se shoqëria \*\*\* ka ushtruar aktivitetin në shkelje ligjore, pa studim gjeologjik, pa respektuar lejen mjedisore etj.* Nisur nga ky pretendim, Komisioni vlerëson se problematikat e natyrës administrative të ushtrimit të veprimtarisë të funksionimit të shoqërisë \*\*\* , të evidentuara qartësisht edhe në aktekspertimet (tekniko-minerare dhe gjeologjike), si ushtrim i veprimtarisë pa leje mjedisore, pa studim gjeologjik, minerar etj. është provuar gjatë gjykimit të çështjes dhe për këtë qëllim ndaj shoqërisë \*\*\* autoriteti përkatës ka marrë masat ligjore konkrete, duke revokuar edhe lejen e mjedisit. Lidhur me këtë moment procedural, për sa i takon analizimit të këtyre proceduarve ligjore apo mangësive administrative, por të shkëputura nga elementi shkak-pasojë, për të cilin është ngritur padia, gjykata ka vlerësuar se: “*Për sa kohë nuk vërtetohet/provohet në mënyrë të qartë lidhja shkak - pasojë ndërmjet veprimeve dhe sjelljes me faj të palës së paditur, shoqërisë \*\*\* dhe shkaktimit të dëmit palës paditëse – nuk është gjetur me vend trajtimi i mungesës së kushteve apo kërkesave të tjera ligjore të shoqërisë paditëse, të cilat nuk mund të jenë objekt i kërkesëpadisë, që lidhet vetëm me kundërshtimin e kërkuar për dëmin e pretenduar si të shkaktuar nga sjellja e palës së paditur.*”

---

<sup>36</sup>Në dosjen gjyqësore gjenden edhe aktekspertime të hartuara si nga vetë palët, por edhe nga ekspertë të tjerë, për të cilët janë marrë vendime për revokimin e tyre, për shkak të heqjes dorë nga detyra, si dhe nisur nga fakti se nuk kanë qenë ekspertët e duhur për vlerësimin e kërkuar, të cilët janë bërë edhe shkak për zgjatjen e gjykimit.

<sup>37</sup>Pjesë e dokumentacionit të dosjes gjyqësore rezultoi të jetë edhe procesverbal i konstatimit të datës 11.11.2016, nga Bashkia Dibër, Emergjencat Civile, për shkaktimin e dëmit në biznesin e denoncuesit/paditësit në të cilin cilësohet se faktor janë prurjet e fuqishme të lumit S.

93. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni merr në konsideratë faktin se vlerësimi i aftësive profesionale kryhet mbi aspektin etik dhe procedural për të evidentuar shkelje të mundshme të drejtave të palëve, pa i nënshtruar në analizën faktiko-ligjore vlerësimet e provave dhe vendimmarrjet, të cilat lidhen me themelin e çështjes. Në të kundërt do të gjendej në zëvendësim dhe interpretim të logjikës së gjyqtarit, gjë e cila do të kapërcente kompetencat e Komisionit.
94. Gjithsesi, përpos shkaqeve të denoncimit të lartpërmendur, Komisioni, lidhur me çështjen në fjalë dhe vendimin nr. \*\*\*, të vitit 2021, pasi është mbyllur hetimi administrativ, e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë shpjegime edhe lidhur me: (i) mosevidentimin në pjesën arsyetuese të vendimit për sa i takon pasqyrimin kronologjik të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Tiranë dhe të Gjykatës së Lartë; (ii) mosargumentimin mjaftueshëm të kërimit të dytë në objektin e kërkesëpadisë; (iii) arsyet e komunikimit/njoftimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 9.6.2021, të palëve gjyqësore, në kapërcim të afatit procedural, të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile; (iv) përfundimin e shqyrtimit të çështjes përtej afatit procedural të parashikuar.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

95. Në prapësimet e dërguara, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se për sa i takon mospasqyrimin në vendim të kronologjisë së vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Tiranë dhe të Gjykatës së Lartë ka menduar se nuk ka qenë e domosdoshme. Ndërsa për sa i takon kërkit të dytë të objektit të kërkesëpadisë për aq kohë nuk janë vërtetuar lidhjet shkakësore ndërmjet sjelljes së paligjshme e me faj të palës paditëse dhe dëmit të shkaktuar, ka vlerësuar se nuk ka pasur vend për të trajtuar më tej këtë kërkim të padisë.
96. Lidhur me dorëzimin e vendimit në tejkallim të afatit 20-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile, subjekti ka shpjeguar se vonesa ka ardhur si rezultat i kompleksitetit të çështjes dhe se shqyrtimi i çështjes ka zgjatur përtej afatit procedural prej 9 muajsh, për shkak të kryerjes së aktekspertimeve të akuakulturës dhe të aktekspertimit kontabël.
97. Bashkëlidhur shpjegimeve të depozituara, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe vendimin nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet të cilit, ky institucion ka vendosur arkivimin e një ankese – të paraqitur, pikërisht, për shkelje të mundshme të subjektit përgjatë shqyrtimit të çështjes në analizë. Nga ky organ (ILD) nuk janë evidentuar të dhëna që të tregojnë se sjellja apo veprimet e gjyqtarit Edvan Veçani të kenë qenë të natyrës së tillë që të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas parashikimeve ligjore dhe se, sipas ILD-së, pretendimet për zbatim të gabuar të ligjit apo mosrespektim i legjisllacionit procedural është kompetencë e gjykatave më të larta.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

98. Komisioni, nisur nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me dorëzimin e vendimit në tejkallim të afatit ligjor dhe shqyrtimit të çështjes përtej afatit të përcaktuar dhe mospërshekrimin e vendimeve të gjykatave për shqyrtimin e kompetencës, çmon se ato nuk mund të klasifikohen si mangësi profesionale. Për më tepër duhet të mbahet në vëmendje që subjekti ka zëvendësuar një kolege, që kishte shqyrtuar më herët këtë dosje. Pra, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes në fjalë nuk mund t'i atribuohet vetëm veprimtarisë së subjektit. Gjithsesi, trupi gjykues çmon se faktet e konstatuara lidhur me kapërcimin e afateve – edhe nëse nuk do të çmoheshin të justifikuar nga



kompleksiteti i çështjes dhe nga shqyrtimi i pjesëshëm – ato nuk vlerësohen të mjaftueshme në vetvete për të prodhuar ndonjë penalizim për subjektin e rivlerësimit.

99. Gjithashtu, në vlerësim të shpjegimeve të tjera të subjektit të rivlerësimit, por edhe nisur nga fakti që ankesa lidhur pikërisht me këtë çështje është arkivuar nga ILD-ja, pasi nuk janë konstatuar shkelje ligjore, nënkupton mungesën e ndonjë shkeljeje etiko-procedurale të kryer nga subjekti i rivlerësimit. Kështu as Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë shkelje etiko-procedurale apo mangësi profesionale nga subjekti, lidhur me këtë çështje.

### **FAKTE TË NJOHURA BOTËRISHT**

100. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është vënë në dijeni nga mjetet e informimit publik lidhur me artikullin e botuar në median *online* ku citohej se: “[...] gjyqtari A. K., i cili po shqyrtonte një pjesë të ‘Dosjes \*\*\*’ tha në seancë gjyqësore se ishte përjashtuar nga çështja me vendim të zv. kryetarit të Gjykatës Dibër, Edvan Veçani. Gjyqtari K. u përjashtua me kërkesë të avokatëve sepse kishte vendosur ndarjen e dosjes dhe gjobitjen e tyre në mungesë”.
101. Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 30.10.2021, të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me shkresën nr.\*\*\* prot. ka konstatuar se shtetasit D.Gj. dhe N. M. kanë kërkuar në seancën gjyqësore, që po zhvillohej ndaj tyre, përjashtimin e gjyqtarit A. K. nga gjykimi i çështjes penale nr. \*\*\*, datë 1.4.2021. Të pandehurit kanë paraqitur kërkesë për përjashtimin nga gjykimi të gjyqtarit duke argumentuar se kishin humbur besimin për shqyrtimin në mënyrë të drejtë prej tij. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit dhe pasi ka analizuar kërkesën dhe pretendimet e palëve, gjyqtari, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.10.2021, ka vendosur “Përjashtimin e gjyqtarit”, duke vlerësuar se “... gjyqtari nuk ka treguar njëanshmëri në punën e tij, por meqenëse pala kërkuese ka humbur besimin, duke shfaqur dyshime mbi çështjen, kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit duhet pranuar me qëllim ruajtjen e objektivitetit”.
102. Nisur nga sa më sipër, Komisioni, duke vlerësuar përmbajtjen e denoncimit në fjalë në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe tipologjinë e objektit të vendimmarrjes së subjektit, çmon se nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionimit të tij.
103. Në konkluzion, trupi gjykues, duke e parë në tërësi rivlerësimin e aftësive profesionale, vlerëson se për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje të rënda procedurale dhe/ose mosrespektim i të drejtave të palëve, me pasoja për këta të fundit apo arsyeime të dobëta ose të paplota në vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në këto kushte, çmon se z. Edvan Veçani ka arritur një nivel kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Edvan Veçani:

- a) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

- b) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Edvan Veçani, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në datën 28.10.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Relator**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*